



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 133
Prishtinë, më 28 tetor 2010

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 TETOR 2010**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

1. Deklarimet e deputetëve

Në fillim të mbledhjes, deklarime paraqitën këta deputetë: Qamile Morina, Shkumbin Demaliaj, Ismajl Kurteshi, drita Maliqi, Mark Krasniqi, Danush Ademi, Dritë Kadriu, Emrush Xhemajli, Riza Smaka, Ibrahim Gashi dhe Driton Tali, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Abdyl Ymeri**, parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Enver Hoxhaj lidhur me ngritjen e cilësisë së mësimit dhe pajisjen e shkollave me teknologji informative dhe laboratorë, por ministri Hoxhaj nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** parashtroi pyetje ministres së Energjetikës dhe Minierave lidhur me procesin e privatizimit të Boksive të Kosovës, por ministrja Shiroka-Pula nuk ishte e pranishme në mbledhje.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve dhe atyre publike, por ministri Shala nuk ishte e pranishme në mbledhje.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me mundësitë e eksportimit të patates dhe të produkteve të tjera bujqësore në Shqipëri.

Kryeministri i Kosovës, **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me kthimin e pensioneve për pensionistët kontributdhënës, por ministri Ahmet Shala nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputeti **Driton Tali** parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me kthimin e pensioneve për pensionistët kontributdhënës, por ministri Ahmet Shala nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputeti **Riza Smaka** parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me politikën dhe veprimet e MEF ndaj institucioneve mikrofinanciare për normat e larta të interesit që zbatohen ndaj bizneseve të vogla në Kosovë, por ministri Ahmet Shala nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Deputetja **Gjynaze Sylaj** parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me kthimin e pensioneve për qytetarët e Kosovës, që pensionet e tyre i kanë Republikën e Maqedonisë, por ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në mbledhje.

Pastaj, kryetari konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 82 deputetë dhe procedoi me punimet e mbledhjes.

Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Ndërkohë, kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, z. Bahri Hyseni ka propozuar, me shkrim, amendamentimin e rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, propozoi që në rend dite të mbledhjes së sotme të radhitet edhe shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kryetari, para se ta vënte në votim plotësimin e rendit të ditës, propozoi që Kuvendit të Deklarohet për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----76,

Kundër----- 3,

Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që të shmanget nga Rregullorja e Kuvendit gjatë shqyrtimit të projektligjit për zgjedhjet.

Pastaj, kryetari dhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për plotësimin e rendit të ditës. Rezultati i votimit, ishte si vijon:

Për-----shumica absolute,

Kundër-----0,

Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, njëzëri vendosi që ta vë në rend dite, si pikë e 4-të Shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-132 për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rezervat shtetërore të mallrave,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/33 për blegtorinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologji,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,
15. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e Strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar,
16. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale,
17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë lidhur me Propozim-strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025,
18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për qytetin e Prishtinës, dhe
19. Formimi i Organit të Pavarur Përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtura më 14 tetor 2010

Para se të miratohej Procesverbali, kryetari sqaroi se konstatimin në procesverbal lidhur me pikën e 7-të. Vendimmarrja e deklaruar, në mbledhje plenare, është kontestuar nga një numër i deputetëve se nuk është deklaruar numri i deputetëve të pranishëm në sallë.

Më qellim të arritjes se një konsensusi të plotë në mes të të gjitha grupeve parlamentare, për çështjen në interes të vendit, propozoi që Procesverbali i mbledhjes plenare të mbajtur me 14 tetor 2010, të korrigjohet me konstatimin, si vijon: “ nuk është miratuar Propozim-Strategjia dhe vendimi i Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Post - Telekomit të Kosovës dhe se ky Dokument do të rikthehet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend”.

Me përmirësimin e cekur më lart, Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur me 14 tetor 2010.

4. Shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni.

Pas arsytimit të këtij projektligji nga ana e z. Hyseni, kryesuesi hapi debatin.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Slobodan Petroviq dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliq, si dhe deputetët: Bujar Dugoli, Fatmir Rexhepi, Emrush Xhemajli, Driton Tali, Rexhep Hoti, Ismajl Kurteshi, Gjylnaze Sylja, Naim Rustemi, Shkumbin Demaliaj, Berim Ramosaj, Ramë Manaj, Hydajet Hyseni, Zylfi Merxha, Ibrahim Makolli, sanije Aliaj, Zef Morina, Danush Ademi, Gani Buçinca, Njomza Emini, Zylfije Hundozi, Bahri Hyseni, Kaçusha Jashari dhe zv. kryeministri Haredin Kuçi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, si dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës, në pajtim nenin 41 të Ligjit Nr. 03/L 209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 25 tetor 2010, i ka rekomanduar Kuvendit shkarkimin e guvernatorit të BQK-së, Hashim Rexhepi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë rekomandim, dhanë deputetët: Shkumbin Demaliaj, Rustem Mustafa, Riza Smaka, Nait Hasani dhe Ismet Beqiri, që janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,
Kundër-----2,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi miratoi Rekomandimin e Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e Guvernatorit të BQK-së, Hashim Rexhepi.
2. Vendimi i dërgohet ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, për veprime të mëtejshme.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetari i këtij komisioni Gani Koci.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Gashi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1 dhe 2.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rezervat shtetërore të mallrave

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Rezervat shtetërore të mallrave.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetari i këtij komisioni Gani Koci.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Koci, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Rezervat shtetërore të mallrave.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme nuk pati të paraqitur për arsyetimin e raporteve.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet e propozuara veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, dhe 23.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----67,

Kundër----- 0,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/33 për blegtorinë

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/33 për blegtorinë.

Nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme nuk pati të paraqitur për arsyetimin e raporteve.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentin vetëm të propozuar.

Kuvendi miratoi amendamentin, nr. 1.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentin e miratuar, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----71,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/33 për blegtorinë.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

Nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme nuk pati të paraqitur për arsyetimin e raporteve.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet e propozuara veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, dhe 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----66,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa e arsyetoi kryetari i këtij komisioni Gani Koci, ndërsa në emër të Komisionit për Punë të brendshme dhe Siguri, Basri Musmurati. Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Musmurati, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: Amendamenti nr. 1 i plotësuar, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, dhe 22.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuarra shtetërore për siguri.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologji

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për metrologji.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport dhe Telekomunikacion– komision raportues, e arsyetoi anëtari i këtij komisioni Fatmir Rexhepi.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Rexhepi, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- ///,
Kundër----- ///,
Abstenime----- ///.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për metrologji.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme nuk pati të paraqitur për arsyetimin e raporteve.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

Raportin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport dhe Telekomunikacion– komision raportues, e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni Myzejene Selmani.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e znj. Selmani, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4 dhe 5.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për tregtinë e mallrave strategjike.

15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar e arsyetoi ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-vendim, dhanë: në emër të Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, Rustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramadan Avdiu, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliç, si dhe deputeti Bujar Dugolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër----- 0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-vendim, dhanë: në emër të Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, Rustem Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, si dhe deputetët: Nait Hasani, Gjylanze Sylja, Ibrahim Gashi, Rexhep Hoti, Shkumbin Demaliaj, Rustem Mustafa dhe Hajdin Abazi që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----25,
Kundër-----32,
Abstenime-----11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nuk miratoi vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave.

17. Shqyrtimi i Propozim-strategjisë minerare të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2010 - 2025

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport dhe Telekomunikacion, e ka shqyrtuar Propozim-strategjinë minerare të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2010 – 2025 dhe Kuvendit i ka rekomanduar mos miratimin e saj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-strategji, dhanë: në emër të Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ramë Buja, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Fatmir Rexhepi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, si dhe deputetja Sala Berisha - Shala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport dhe Telekomunikacion, për mos miratimin e Propozim-strategjisë minerare të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2010 – 2025. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----50,
Kundër----- 2,
Abstenime-----9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Rekomandimin e Komisionit parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjikë, Transport dhe Telekomunikacion, për mos miratimin e Propozim-strategjisë minerare të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2010 – 2025.

18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për Qytetin e Prishtinës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, e ka shqyrtuar Projektligjin për Qytetin e Prishtinës dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ky Projektligj të mos miratohet dhe ti kthehet Qeverisë, për ripunim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Rekomandim, dhanë: në emër të Komisioni parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media dhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajredin Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Numan Baliç si dhe deputetët: Gani Buqinca, Ardian Gjini, Sabri Hamiti dhe Ramadan Avdiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, që Projektligji për Qytetin e Prishtinës t'ia kthejë Qeverisë për ripunim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 31,
Kundër----- 25,
Abstenime-----11.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Rekomandimin e Komisionit parlamentar për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, që Projektligji për Qytetin e Prishtinës ti kthehet Qeverisë për ripunim.

19. Formimi i Organit të Pavarur Përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me nenin 96.4 të Ligjit për prokurim publik dhe me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit, ka propozuar tre gjyqtarë për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e Këshilli Gjyqësor i Kosovës për formimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----38,
Kundër-----12,
Abstenime-----8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash e miratoi propozimin për formimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në këtë përbërje:

1. Shukri Sylejmani, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës,
2. Nehat Idrizi, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, dhe
3. Rasim Rasimi, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Gjiilan.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale